



Pranimi / Dorëzuar Prilazje / Prilazje Received / Delivery	09 - 01 2019	viti god year	
Organi / Njësia Organi / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Bil. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHOK	96/2019		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Anr.783/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Lela Petkovic dhe Malësore Gashi – Bajraktari anëtare, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.783/2018, të datës 27.11.2018, së ankueses Rexhep Azemi, me adresë banimi Ulpiana A7 H-3 Nr. 1 , nga Komuna e Prishtinës, me përfaqësues juridik avokat Fitim Malokaj, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 09.01.2019, mori këtë

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa A. Nr. 783/2018, e datës 27.11.2018, e parashtruar nga ankuesi Rexhep Azemi.
- II. MBETET NË FUQI.** Vendimi Nr. 14-016/01-0179419/18, i datës 16.11.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.11.2018, ka nxjerr vendim A.nr. 587/2018, me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Prishtinës, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15), të bëjë rishqyrtimin e ankesës së ankuesit të datës 23.07.2018, të parashtruar nga ankuesi Rexhep Azemi.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës, me datën 16.11.2018, me numër protokoll Nr. 14-016/01-0179419/18, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në Ligj.

Ankuesi Rexhep Azemi, i pakënaqur me vendimin me nr. protokoll Nr. 14-016/01-0179419/18, datës 16.11.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, brenda afatit ligjor me pajtim me Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit Juridik avokat Fitim Malokaj, me datën 27.11.2018 me numër protokoll 7170//2018, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A nr. 783/2018, e datës 27.11.2018, me numër protokollit 7170/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimi i datës 16.11.2018, me numër protokollit Nr. 14-016/01-0179419/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; urdhëresë e datës 07.03.2007; vendimi i datës 01.09.2008, i Komisionit Disiplinor; Ankesa e datës 20.08.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; kërkesë për Kthim në punë e datës 04.02.2010; kërkesë e datës 14.04.2010, drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm , Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 27.10.2015; Aktvendim i datës 23.10.2015, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; kërkesë për kthim në punë e datës 12.11.2015; padia e datës 16.11.2017, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendim i datës 03.11.2017, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendim i datës 13.06.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesa e datës 17.09.2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 01.11.2018, me numër A. Nr. 587/2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesë e datës 23.07.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Autorizimi i datës 14.09.2018; Vendimi i datës 30.07.2008, i Komisionit Disiplinor; Aktvendim e datës 09.09.2015, P. Nr. 2899/2011, i Gjykatës Themelore në Prishtinë ; kërkesë për Kthim në punë e datës 20.06.2018; Vërtetim i datës 09.12.2009; Padi e datës 14.07.2016; kërkesë për Kthim në punë e datës 04.02.2010; kërkesë për kthim në punë e datës 12.11.2015; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 27.10.2015; kërkesë e datës 14.04.2010; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 27.10.2015.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Rexhep Azemi, **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstatuar, se Gjykata Themelore Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative me datë 03.11.2017, ka nxjerr aktvendim me të cili ka detyruar paditësin Rexhep Azemi, të dorëzojë precizoj gjykatës aktin administrativ të cilin e konteston dhe të paraqes dëshmi se para organit administrativ, a ka shterur mjetet juridike paraprakisht, ndërsa ankuesi Rexhep Azem me datën 16.11.2017, ka bërë precizimin e padisë, ndërsa Gjykata Themelore Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 13.06.2018 ka nxjerr aktvendim me të cilin ka hedhur poshtë padinë e paditësi të datës 02.08.2016, për kthimin në vendin e punës si të parakohshme, ndërsa ankesën ankuesi e ka parashtruar me datës 23.07.2018, në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Prishtinës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me datë 30.07.2008, ka nxjerr vendim me të cilin ka shqiptuar masën disiplinore „ **Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës në shërbimin Civil të Kosovës**”, ndërsa ankesën e ka parashtruar me datë 23.07.2018 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Prishtinës e që është në kundërshtim me hapin 7 pika 7.1 të Urdhëresës Administrative Nr. MSHP/ DASHC 2003/05, për zbatimin e Urdhëresës Administrative 2003/2, zbatimin i Rregullores së UNMIK-UT, Nr. 2001/36, mbi shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet se “**Ankesat duhet të paraqiten sa më shpejt pas ngjarjes me të cilën kanë lidhje. Në rastin e ankesës kundër selektimit, ngritjes në pozitë ose vendimeve të Komisionit disiplinor ankesat duhet të paraqiten brenda 30 ditëve**”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës , me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Nr. 14-016/01-0179419/18, të datës 16.11.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme



Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankuesit Rexhep Azemi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda Nr. Anr. 783/2018**

  
**Eshtref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit



  
**Rushit KAJTAZI**  
Procesmbajtës

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit Rexhep Azemi;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Përfaqësuesit Juridik Avokatit Fitim Malokaj;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

